

Fjalë shqip - sanskritisht

KUJ, kujati, kujita - **kujë, kujit** - nxjerr një tingull të pashquar, thërras; rënkoj, vë gjëmën, vë kujën, VRT, vartate, vartitum, vrtta - **vërtit, vërtitun, vërtita**

kona - **kon, kënd, kand**

are! - **ore! are!** - pasthirmë

lasa - **los, loz** - me lujtë, me vallzue

LAP - **llap** - me llapë

çikha - **çukë** - majë

vali - **valë** - palë sidomos e rrumbullaktë; rrudhë

varsa - **bër shi, vërshoj, vërsë** - shi, vit, moshë

tiras - **thërras** - bërtas, qortoj, shaj, kundërshtoj

VAL - valate, vavala, valayati, valita, valitva - **valle, valloj, vallëzoj, valëvitem** - me u kthye, me u kthye nga, me u përkul; me kthye, me shkue e ardhë

VELL - **valle, vallëzoj, valë** - me u lëkundë, me valëzue, me u rrokullisë, i valëzuar, i kërrusur, i përdredhur

Vac - **vikat** - zë, fjalë, tingull, shprehje

cud - **cyt** - eksitoj, nxit

vacas - **vikas** - fjalë, ligjërim

vasa - **vise** - vend, lokalitet

bhasana - **bëzanë** - të folurit, të biseduarit, gjuhë, gjuhë e folur, dialekt,

bhasa - **bëza** - gjuhë e folur, dialekt

BHAS, bhasate-ti, babhasa, bhasita -bhasitua, bhasya - **bëza, bëzita, bëzitun** - me i folë dikujt, me thënë me quejt; me qenë thënë, me u bëzajt dikjt

BHR, bharta, bhartun, bhyrta - **bar, bart, bartun** - me bartë, me sjellë, me durue

ç - rri për ndarje, për mohim, për të kundërt.

Mund të tregojmë se ai lidhet me foljen shqipe **ça - me ça, çaj, çan, çamu-n etj.**

që shpreh kuptimin e ndarjes, kuptim ky që mund të paraqitet simbolikisht si Ø, ku simboli O rri për të tërën dhe vija I pregon ndarjen e saj. Vëmë re se simboli Ø mund të vështrohet si një C - atëherë kemi gërmën C (copë, ca, çaj) edhe si Ç, si një variant i zbutur i saj, dhe si D, (daj, darje - ndarje).

Vëmë në dukje gjithashtu, me këtë rast, se shkrimi i gjuhës, siç dihet, ka filluar me piktograme dhe se vetë gërmat e alfabetit që kanë rrjedhur prej tyre, janë trajta të evoluara të tyre, sikundër historia e alfabetit e provon fare mirë.

Nga ana tjetër veprimi i ndarjes dhe ai i mohimit janë identifikuar, në sferën e semantikës, nga popujt e lashtë mes tyre, domethënë janë vështuar semantikisht ekuivalentë. Një situatë e tillë do të paraqitet simbolikisht kështu:

- O — —» Ø

*Kjofsh DA prej nesh*

Ideograma Ø që i përgjigjet pikërisht nocionit të digës, si një mjet për ndarje. Një zbërthim më i imët, brendapërbrenda sistemit të gjuhës shqipe, jep:

**D jam ba**

ku tërë pesha kuptimore mbahet nga operatori D, që përbëhet në këtë rast nga një gërmë e vetme.

Përfitojmë nga ky rast për të vënë në dukje sa vijon:

damun = **D** jamun (jamun D)  
lamun = **L** jamun (jamun L)  
shamun = **SH** jamun (jamun SH)  
thamun = **TH** jamun (jamun TH)  
pamun = **P** jamun (jamun P)  
kamun = **K** jamun (jamun K)  
ramun = **R** jamun (jamun R)

Këto shëmbuj tregojnë se kuptimi i këtyre fjalëve peshon i gjithi mbi një gërmë të vetme (d, l, sh, th, p, k, r) kurse pjesa tjetër, e përbërë nga folja jam, funksionon vetëm si një zgjerim teme, pa vlerë semantike. Kjo tregon se vetë gërmat e alfabetit lozin rolin e ideogramave. Le të vëmë re me këtë rast, se në shqip:

da, la, sha, tha, pa, ka, ra, ... janë monosilabe.

Këto shëmbuj tregojnë për karakterin zanafillor monosilabik të shqipes dhe ruajtjen e tij.

Vëmë re se edhe në gjuhët e lashta, zanorja është vështruar si një element dytësor dhe arbitrar e pra fakultativ dhe si i tillë, jo kuptim mbartës (në kuptimin më të thellë të fjalës). Zanorja, duke përfaqësuar zërin, shpesh-herë nuk fiksohej fare, po shtohej nga folësi.

Duke u kthyer tani atje ku e lamë, shtojmë se gllosat e huaja që përmendëm më sipër lidhen me operatorin shqip **da**, **damun** ashtu sikundër edhe fjala greqisht: **Demon** - demon, djall; me qenë se, siç na tregon mitologjia, demon-i është vështruar nga popujt primitivë si një qenie që është *ndarë nga e tëra*, nga Zoti.

**damun** - *dam, dhaimon, verdammy, Daumen, damba, Damm, to condemm, dannare*

**Damm = digë**

duke shprehur *diga* nocionin e *ndarjes*, duke qenë **diga** një objekt që *ndan*, është e qartë se duhet të përmbajë nocionin e *ndarjes*, duhet të na japë idenë e *ndarjes*, e pra duhet të shprehë situatën që krijon ideograma **Ø**. Ndryshe nga vetë gjuha gjermane, shqipja e motivon farë mirë këtë fjalë të gjuhës gjermane nëpërmjet operatorit të saj të lirë **damun**.

Përfundimet e autorit Petro Zheji

Duke u mbështetur vetëm tek shëmbulli i operatorit **da**, jemi në gjendje të flasim që tani, sadopak, për mundësinë e një zhvendosjeje të matricës, nga sanskritishtja tek shqipja, dhe ja përse: fjalët *damm, verdammt, daumen, dajmon, demone, demonium, dannare, condannare, condemn, damba, dommage, danno* etj, lidhen të gjitha siç e pamë më sipër, me pjesoren e foljes **da** të shqipes. Nga ana tjetër është e vërtetë që operatori **da (dha)** ekziston i lirë jo vetëm në shqip, por edhe në sanskritisht, mirëpo në këtë gjuhë të fundit nuk ekziston një pjesore e kësaj foljeje në trajtën **damun**. Prandaj pra dhe lidhja më e drejtëpërdrejtë e më e pastër e të gjithë këtyre fjalëve të huaja është me shqipen dhe jo me sanskritishten.